



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOMUNËS / SKUPŠTINA OPŠTINE / MUNICIPAL ASSEMBLY
SHTIME / ŠTIMLJE
Nr.01-060/01-26958/23, datë:04.10.2023



Npi – 01/391 datë: 03.11.2023

Në bazë të nenit 12 dhe 41 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040; Udhëzimi Administrativ të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal Nr.2009/01 për procedurën e zgjedhjes dhe përgjegjësitë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, si dhe pas shpalljes së rezultateve të numëruara të votave të mshefta për zgjedhjen e Kryesuesit nga Komisioni Votues, Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e Jashtëzakonshme, të mbajtur më 03.11.2023, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR ZGJEDHJEN E KRYESUESIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES
ADNAN ADEMI

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -VI- të Jashtëzakonshme, të mbajtur më datë 03.11.2023, me 11 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim” miratoi Vendimin për zgjedhjen e z.Adnan Ademi - Shtime, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Shtimes.

II

Përgjegjësitë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës janë të përcaktuara me nenin 41 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040, si dhe të Udhëzimit Administrativ, Nr.2009/01 për procedurën e zgjedhjes dhe përgjegjësitë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

III

Mandati i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës është i njëjtë me mandatin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Kryesuesit të zgjedhur, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i mbledhjes
Muhamet Ademaj